



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

*Data 31/10/2022*

Drejtuar: OE “LEON Group” Shpk, me adrese Bulevardi “Blu”, Pallati “Blu” Nr.11, Kati 1, Kamez, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e Thjeshtuar/Mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-45161-10-10-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi”.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 dite nga nenshkrimi i kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ATLANTIK 3” SH.P.K, me Nuis K22218003V dhe me oferte ekonomike 2,998,485 (dymilion e nenteqind e nentedhete e tete mije e katerqind e tetedhete e pese) Lek pa TVSH,
2. Operatori Ekonomik “EURO MEGA 2010” SH.P.K, me Nuis K91624505A dhe me oferte ekonomike 2,650,000 (dy milion e gjashteqind e pesedhete mije leke) Lek pa TVSH,
3. Operatori Ekonomik “LEON Group” SH.P.K, me Nuis L51313013I dhe me oferte ekonomike 3,287,245.9 (tre milion e dyqind e tetedhete e shtate mije e dyqind e dyzet e pese pike nente) Lek pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**I-Operatori Ekonomik Operatori Ekonomik “ATLANTIK 3” SH.P.K, me Nuis K22218003V,**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 2.3.3, ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar per mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Dokumenti i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”*, pasi duke qene se nuk eshte prodhues per te gjithë mallrat e kerkuara OE duhet te paraqese autorizimet/ marreveshjet per mallrat qe nuk eshte prodhues.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE si dhe ofertes teknike rezulton se OE ka paraqitur autorizim prodhuesi nga “ECOICHEM SRL”, per 12 artikuj, ndersa per 26 artikujt e tjere i eshte referuar disa prodhuesve te tjere nga te cilet nuk ka paraqitur Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar.

Per me teper KVO veren se per artikujt Mushama, perparese, çizme, kapuç kuzhine, perparese kuzhinierereje, ne oferten teknike te paraqitur nga ky OE, i eshte referuar si emertim kompanie prodhuese “TREG”, duke mos paraqitur asnje Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar per keto artikuj.

**Se dyti**, nuk ploteson kriterin 2.3.4 ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet te paraqese katalog ose fragmente katalogu per te gjith artikujt objekt prokurimi”*, pasi nga verifikimi ne SPE rezulton se OE ka paraqitur katalog vetem per 12 artikujt per te cilet ka paraqitur autorizim prodhuesi nga “ECOICHEM SRL”.

KVO veren se per 26 artikujt e tjere ky OE nuk ka paraqitur katalog ose fragment katalogu duke mospermbushur kete kriter.

**Se treti**, nuk ploteson kriterin 2.3.6, ku parashikohet se: *“Per produktet: Doreza pune, Maska, Përparëse, Doreza nje perdorimshe, Çizme, Perparese kuzhinierereje, Pantofla te bardha, te cilat kane lidhje me mbrojtjen, sigurine dhe shendetin e punojseve te paraqitet Deklaratat e Konformitetit”*.

Operatoret ekonomike per permbushjen e ketij kriteri duhet te paraqesin Deklaratat e Konformitetit te leshuar nga prodhuesi.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje Deklarate Konformitetit nga prodhuesi per artikujt e kerkuar por ka paraqitur nje deklarate nga ana e tij.

KVO veren se ky OE nuk eshte prodhues ose distributor i autorizuar per produktet: Doreza pune, Maska, Përparëse, Doreza nje perdorimshe, Çizme, Perparese kuzhinierereje, Pantofla te bardha dhe si rrjedhoje nuk mund te leshoje deklarate konformiteti per keto artikuj.

---

KVO thekson se eshte papergjegjshmeri te deklarosh konformitetin per produkte te cilat nuk eshte prodhues si dhe duke mos njohur procesin e prodhimit te tyre, pasi keto produkte kane lidhje me mbrojtjen, sigurine dhe shendetin e punojseve.

Po ashtu KVO, veren se edhe Komisioni i Prokuimit Publik me vendimin nr. 825 /2021, ka mbajtur te njejtin qendrim per certifikatat e konformitetit ku citohet se *“III.2.4 Komisioni i Prokurimit Publik bazuar ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, veren se eshte ne te drejten e autoritetit kontraktor te percaktojë kriteret per kualifikim, bazuar ne legjislacionin per prokurimin publik, duke mos i tejkalar kufijte maksimalë te percaktuar ne ketë te fundit, ne funksion te qellimit dhe parimeve te ligjit per prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se paraqitja e certifikatave te konformitetit, eshte e lidhur ngushte me objektin e kontrates dhe duke qene se, autoriteti kontraktor eshte perfituesi direkt i kontrates objekt-prokurimi, eshte ne te drejten e tij te garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që prokurohen, e rrjedhimisht eshte e drejte e ketij te fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata për të vërtetuar konformitetin e prodhimit të produkteve. Certifikatat europiane të konformitetit tregojnë që produktet (mallrat) plotësojnë kërkesat ligjore të markave të komunitetit europian, mbajnë shenjën CE dhe përputhen me direktivat e BE-së, që janë prodhime të sigurta dhe nuk dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin”.*

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 76, pika 3/a dhe ne nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar ne nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me percaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e Operatorit Ekonomik “ATLANTI 3” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

---

***Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “ATLANTIK 3” SH.P.K, me Nuis K22218003V, skualifikohet.***

**II- Operatori Ekonomik “EURO MEGA 2010” SH.P.K, me Nuis K91624505A,**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 1, ne lidhje me Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit dhe pikën 2.1.b, te kushteve te veçanta te kualifikimit “*Formulari permeledhes i vetedeklarimit*”.

KVO, verën se ne shtojcën 7, parashikohet si me poshte:

### ***1. KRITERET E PËRGGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT***

*Ofertuesi deklaron se:*

*a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*

*c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*

*ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*

*d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*

*dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*

*e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

*f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*

*gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*

*i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të*

---

*përfunduar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

Gjithashtu KVO, verën se bazuar në pikën 1 dhe 2 (c), të nenit 26, të VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se:

*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla,*

*2. formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

...dhe për të përmbushur këto kritere duhet të paraqitet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të operatoreve ekonomike në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomike nuk ka plotësuar të dhënat për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, për ortakun Hair Shametaj (i cili zoteron 100% të aksioneve të shoqërisë) në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si më poshtë:

ne kreun A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, në seksionin në lidhje me informacionin dhe deklarin në zbatim të pikës 2 (c) të nenit 26, të VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën duhet të deklarohet si më poshtë:

*“ç) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së”;*

KVO referuar vendimit të KPP nr. 537/2019, date 14.08.2019, në të cilin ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik ankimes në këtë vendim pikerisht sepse nuk ka plotësuar e deklaruar të gjithë emrat sipas formatit të shtojcës 8 të DST. Konkretisht, KPP në këtë vendim shpreh:

*“KPP gjykon se në rastin konkret nuk jemi në kushtet e devijimit të vogël apo pamundësisë së autoritetit kontraktor për të verifikuar se kush është ortakut i shoqërisë, por jemi përballë mosplotësimit në formën e duhur të një shtojcë e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese”. Formati i shtojcës e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë subjekteve të përmendur më sipër në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte*

---

*konceptuar në mënyrë të përgjithshme. Për këtë shkak shtojca e dorëzuar nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar”.*

Sa me lart duke qene se formati i shtojcës 8, e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë personave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit **ose ortakut**, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendim marrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte konceptuar në mënyrë të përgjithshme. Për këtë shkak shtojca nr. 8, e dorëzuar nga OE nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar, duke mos përmbushur kete kriter.

**Se dyti**, nuk ploteson kriterin 2.3.3, ku parashikohet se: *“operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar per mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë aktin e marrëveshjes midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”*, pasi duke qene se nuk eshte prodhues per te gjithë mallrat e kerkuara OE duhet te paraqese autorizimet/ marreveshjet per mallrat qe nuk eshte prodhues.

Nga verifikimi i ofertes teknike rezulton se OE EURO MEGA Sh.p.k eshte prodhues per 15 artikuj. KVO beri verifikim ne QKL ku rezultoi se ky OE disponon leje mjedisi si prodhues.

Per 23 artikujt e tjere bazuar ne oferten teknike te paraqitur nga OE rezulton se paraqitur autorizim prodhuesi nga operator te cilet nuk jane prodhues, pasi nga verifikimi ne QKL, rezulton se nuk disponojne leje mjedisi si prodhues.

KVO thekson se prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisi te aktivitetit te tyre.

**Se treti**, nuk ploteson kriterin 2.3.6, ku parashikohet se: *“Per produktet: Doreza pune, Maska, Përparëse, Doreza nje perdorimshe, Çizme, Perparese kuzhinierere, Pantofla te bardha, te cilat kane lidhje me mbrojtjen, sigurine dhe shendetin e punonjesve te paraqitet Deklaratat e Konformitetit”.*

Operatoret ekonomike per permbushjen e ketij kriteri duhet te paraqesin Deklaratat e Konformitetit nga prodhuesi per artikujt e kerkuar ne piken 2.3.6.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur Deklaratat e Konformitetit nga nje operator ekonomik qe nuk eshte prodhues, pasi nga verifikimi ne QKL, rezulton se ky operator nuk disponon leje mjedisi si prodhues. KVO thekson se prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisi te aktivitetit te tyre.

Po ashtu KVO, veren se edhe Komisioni i Prokuimit Publik me vendimin nr. 825 /2021, ka mbajtur te njejtin qendrim per certifikatat e konformitetit ku citohet se *“III.2.4 Komisioni i Prokurimit*

---

*Publik bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, vëren se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se paraqitja e certifikatave të konformitetit, është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe duke qenë se, autoriteti kontraktor është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që prokurohen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata për të vërtetuar konformitetin e prodhimit të produkteve. Certifikatat europiane të konformitetit tregojnë që produktet (mallrat) plotësojnë kërkesat ligjore të markave të komunitetit europian, mbajnë shenjën CE dhe përputhen me direktivat e BE-së, që janë prodhime të sigurta dhe nuk dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin”.*

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbeshtetur në nenin 76, pika 3/a dhe në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “EURO MEGA 2010” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

***Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “EURO MEGA 2010” SH.P.K, me Nuis K91624505A, skualifikohet.***

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “LEON Group” Shpk, me adrese Bulevardi “Blu”, Pallati “Blu” Nr.11, Kati 1, Kamez, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,287,245.9 (tre milion e dyqind e tetedhjetë e shtate mije e dyqind e dyzet e pese pike nente) Lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**

---